

## MENDIM PAKICE

1. Unë, komisionere Xhensila Pine, kryesuese e trupit gjykues për subjektin e rivlerësimit, kam votuar kundër vendimit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Florian Bonjaku, duke parashtruar arsyetimin tim në pakicë lidhur me sa vijon:

### Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

2. ILDKPKI-ja<sup>1</sup>, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Florian Bonjaku, i cili është subjekt deklarues pranë këtij institucioni që prej vitit 2003, me nr. Indeksi \*\*\*, ka konstatuar se:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka paqartësi dhe mospërputhje lidhur me vlerat dhe burimet financiare të përdorura për pasuritë;
- ka mosdeklarime të pasurisë ndër vite;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

3. Duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara prej saj; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, kam vlerësuar si në vijim.

4. Në deklaratën e pasurisë, subjekti ka deklaruar apartament banimi, me sip. 62.95 m<sup>2</sup>, në Lagjen \*\*\*, rruga \*\*\*\*\*, Durrës, blerë në datën 11.6.2003, në vlerën 100.000 lekë, sipas kontratës nr. \*\*\*, duke deklaruar se e ka blerë jo realisht, vetëm për qëllim dokumentacioni (fiktivisht) prindërve të bashkëshortes, për arsye dokumentacioni, me qëllimin marrjen e një kredie në Bankën Kombëtare Greke.

5. Ndryshe nga deklarimi në deklaratën *Vetting*, në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës të vitit 2003, subjekti deklaroi këtë apartament banimi me sip. 75 m<sup>2</sup>, Durrës, me vlerë 3.500.000 lekë, me burim krijimi kredinë në vlerën 2.700.000 lekë, në Bankën Kombëtare Greke.

6. Në deklaratën e interesave private periodike vjetore të vitit 2008, subjekti deklaroi se kredinë në Bankën Kombëtare Greke e ka përdorur si burim për blerjen e apartamentit të banimit me sip. 69.4 m<sup>2</sup>, në rrugën \*\*\*\*\*, Tiranë, më 17.5.2004, me vlerë 19.432 USD.

7. Nga mandatarkëtimi i depozituar nga ASHK-ja, shitësi i apartamentit të banimit me sip. 69.4 m<sup>2</sup>, në rrugën \*\*\*\*\*, Tiranë, ka paguar vlerën 69.539 lekë, më 17.5.2004, me përshkrimin “taksë për sipërfaqe shitje për metër katror”.

8. Referuar ligjit nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 8/dh, i të cilit parashikon se: “Për qëllim të tatimit për të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatueshme, të ardhurat nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme” dhe neni 11/2, parashikon se: “Tatimi paguhet nga individit që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme para kryerjes së regjistrimit të pasurive ”.

9. Referuar tatimit të paguar mbi të ardhurat e përfituara nga shitësi i pasurisë, çmimi i deklaruar prej tij për efekt të pagimit të tatimit nuk përputhet me vlerën 19.432 USD, e deklaruar si çmim i paguar nga blerësi, në këtë rast, subjekti i rivlerësimit Florian Bonjaku.

10. Subjekti apartamentin e mësipërm e ka deklaruar se e ka shitur në vitin 2011 dhe me të ardhurat e përfituara ka blerë apartamentin e banimit, me sipërfaqe 112.4 m<sup>2</sup>, ndodhur në pallatet e \*\*\*, lagjja “\*\*\*\*”, Tiranë, në vlerën 8.948.000 lekë.

11. Sipas kontratës së shitjes nr. \*\*\*, datë 21.11.2011, shuma ishte likuiduar nga blerësi në favor të shitësit, jashtë zyrës noteriale. Ndërsa me deklaratën e datës 21.11.2011, subjekti deklaroi se pagesat për shlyerjen e apartamentit janë bërë nga shtetasi R. Sh., i cili ka paguar për llogari dhe nën emrin e tij në llogarinë bankare të shoqërisë \*\*\* sh.p.k., shumën 8.948.000 lekë.

12. ASHK-ja nuk e konfirmon pasurinë e mësipërme të regjistruar në emër të shtetasve Florian dhe S. Bonjaku, por informon Komisionin se në emër të subjektit dhe bashkëshortes është regjistruar në datën 22.10.2014, pasuria apartament në rrugën “\*\*\*\*”, p. \*\*\* shk. \*\*\* k. \*\*\*, ap. \*\*\* dhe se mungon akti me të cilin është regjistruar kjo pasuri.

13. Nga analiza e rrethanave faktike është e pamundur të arrihet në një konkluzion të qartë se cilat janë pasuritë dhe se cilat janë deklaratimet e subjektit të rivlerësimit që përputhen me situatën faktike lidhur numrin e pasurive, mënyrën e krijimit të tyre apo burimet e përdorura për to.

14. Për sa kohë subjekti ka dhënë deklaratime kontradiktore, referuar edhe vendimit nr. 11 (JR), datë 3.7.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, është e pamundur të dallohet se cili deklaram është i vërtetë dhe cili ka qenë shkak që subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij.

15. Sa më sipër, kam vlerësuar se konkluzioni i raportit të ILDKPKI-së, se deklarimi i subjektit nuk është i saktë në përputhje me ligjin se ka paqartësi dhe mospërputhje lidhur me vlerat dhe burimet financiare të përdorura për pasuritë dhe se ka mosdeklarime të pasurisë, ndër vite, është i bazuar në prova të ligj dhe subjekti ndodhet në kushtet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3, të nenit 61, si dhe të germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

### **Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës**

16. Nga institucioni i verifikimit, DSIK-ja, bazuar në pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, u dërgua në Komisioni raporti i përditësuar në vijim të raportit të parë, të përcjellë për përshtatshmërinë në vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, me informacionin shpesh të ardhur nga autoritetet verifikuese, për përfshirje në korrupsion pasiv të subjektit të rivlerësimit Florian Bonjaku. Konkluzioni u la në vlerësimin e Komisionit nën dritën e informacioneve të tjera që disponohen si pjesë e gjetjeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ ndaj subjektit të rivlerësimit.

17. Lidhur me procedimin penal nr. \*\*\*, u konstatua se:

18. Procedimi penal në ngarkim të shtetasve S. D. dhe B. D., etj., për kryerjen e veprës penale “kultivim të bimëve narkotike”, është parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal. Subjekti ka urdhëruar regjistrimin në regjistrin e veprave penale të këtyre shtetasve për kryerjen e veprës penale të parashikuar në nenin 284/2 të Kodit Penal.

19. Mbi bazën e dyshimeve të arsyeshme është vendosur ndalimi i shtetasve B. D. dhe S. D. dhe nga prokurori Florian Bonjaku është kërkuar caktimi i masës së sigurimit “arrest në burg”, për veprën penale të parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal.

20. Nga janar të vitit 2020 e në vijim për shtetasit B. D. dhe S. D. nga prokurori Florian Bonjaku hetimet janë për veprën penale “moskallëzim krimi”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal, dhe në datën 27.4.2020, prokurori Florian Bonjaku ka dërguar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë kërkesën për dërgimin në gjyq të shtetasve B. D. dhe S. D. për veprën penale “moskallëzim krimi”.

21. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.5.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka vendosur kthimin për rihetim për të pandehurit apo personat nën hetim B. D., S. D., E. D., B. D. dhe M. L., me argumentin se hetimi nuk është i plotë dhe se nuk janë argumentuar me prova arsyet ligjore të ndryshimit të këtij kualifikimi të veprës penale.

22. Subjekti ka ankimuar vendimin nr. \*\*\*, datë 18.5.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, duke kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe pranimin e kërkesës së organit të prokurorisë për dërgimin në gjyq të çështjes në ngarkim të të pandehurve B. D. dhe S. D., për veprën penale “moskallëzim krimi”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal.

23. Prokuroria e Apelit Tiranë ka kërkuar heqjen dorë nga ankimi i subjektit ndaj vendimit të datës 18.5.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Gjykata e Apelit Tiranë, në datën 15.7.2020, ka vendosur mospranimin e ankimit të subjektit ndaj vendimit nr. \*\*\* akti, datë 18.5.2020.

24. Në datën 11.3.2021, subjekti i rivlerësimit ka dërguar sërish çështjen në gjyq për veprën penale “moskallëzim krimi”, duke arsyetuar se nuk kanë rezultuar të dhëna që mund të ndryshonin pozitën procedurale të shtetasve B. D. dhe S. D.

25. Transkriptimi i bisedës së mesazheve në kërkesën për gjykim të datës 11.3.2021 nga subjekti Florian Bonjaku nuk është i plotë, krahasuar me tekstin e po këtij transkriptimi të pasqyruar në aktet e hetimit, duke zbehur kështu vlefshmërinë procedurale të saj, me qëllim lehtësimin e pozitës së dy të pandehurve.

26. Subjekti i rivlerësimit, pasi iu kalua barra e provës, nuk ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me këtë çështje. Subjekti nuk arriti të provojë se përse kërkesa për gjykim nuk u bazua në përgjimin e realizuar dhe përse u zbeh vlefshmëria procedurale e saj. Transkriptimi i bisedës së mesazheve, i referuar në kërkesën për gjykim të datës 11.3.2021 nga subjekti Florian Bonjaku, nuk është i plotë krahasuar me tekstin e transkriptimit të pasqyruar në aktet e hetimit.

27. Subjekti i rivlerësimit nuk ka argumentuar se cilat ish-in provat e tjera që u përfituan edhe nga hetimet shtesë pas detyrave të lëna nga gjykata e shkallës së parë, si dhe arsyet ligjore të ndryshimit të kualifikimit të veprës penale për shtetasit B. D. dhe S. D., nga “kultivim të bimëve narkotike” në “moskallëzim krimi”.

28. Bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në vlerësim të raportit të DSIK-së, rezultateve të hetimit lidhur me çështjen e referuar më lart dhe në kuadër të çmuarjes së shpjegimeve dhënë edhe subjekti, kam krijuar bindjen se informacionet që disponoheshin në ngarkim të subjektit të rivlerësimit Florian Bonjaku, sipas kërkesave të germave “b” dhe “c”, të nenit 37, të ligjit nr. 84/2016, ish-in bazuar në fakte dhe rrethana konkrete dhe se në këndvështrimin e përgjithshëm edhe nëse ky informacion nuk do të ishte i mjaftueshëm për të arritur në një konkluzion lidhur me kontrollin e pastërtisë së figurës së subjektit, nga të dhënat e administruara si rezultat i informacioneve të organeve ligjzbatuese, rezultojnë rrethana, të cilat, së paku, cenojnë shkallën e besueshmërisë së subjektit të rivlerësimit në zbatim të pikës 2 të nenit 4 dhe pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

29. Moskryerja e të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme, mënyra jo e saktë e vlerësimit të fakteve dhe provave, argumentimi jo i plotë dhe jo në përputhje me dispozitat ligjore, bien

ndesh me kriteret e parashikuara në pikat 2 dhe 3 të nenit 73 dhe pikës 4, të nenit 74, të ligjit nr. 96/2016, si dhe të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

### **Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale**

30. Subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime lidhur me procedimin penal nr. \*\*\*, në kuadër të një denoncimi, nga analizimi i të cilit u konstatua se:

- a) Kërkesa për pushimin e çështjes penale nr. \*\*\*, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, i është njoftuar vetëm personit të dyshuar B. G. (e pasqyruar në kërkesën për pushim nga subjekti Florian Bonjaku) dhe jo kallëzuesit R. M., në kundërshtim me nenin 329/a/4 të Kodit të Procedurës Penale.
- b) Subjekti i rivlerësimit ka zgjatur hetimet çdo 3 muaj për një periudhë gati 2-vjeçare (9.11.2019 – 9.11.2021), me arsye marrje dokumentacioni shtesë nga Bashkia Krujë, ndërkohë që kërkesa i është dërguar bashkisë në datën 10.3.2021, pas 15 muajsh, në kundërshtim me nenin 324/2 të Kodit të Procedurës Penale.
- c) Nuk rezulton që vendimet për zgjatjen e afatit të hetimeve t'u jenë njoftuar palëve të interesuara, sipas përcaktimeve të nenit 324/3 të Kodit të Procedurës Penale.

31. Subjekti nuk dha shpjegime bindëse mbi gjetjet dhe të metat e veprimeve procedurale të kryera prej tij dhe të konstatuara në aktet e fashikullit procedural konkret.

32. Mangësitë në kryerjen e veprimeve hetimore dhe arsyetimin e akteve procedurale kanë sjellë pasoja në mbrojtjen e posaçme ligjore të të drejtave procedurale të të dëmtuarit nga kryerja e veprës penale, duke cenuar besimin e publikut te drejtësia, sipas pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

33. Pas shqyrtimit të provave, në tërësinë e tyre, kam arritur në konkluzionin se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, lidhur me kriterin e pasurisë dhe ka cenuar besimin e publikut te drejtësia, duke votuar për shkarkimin nga detyra të tij bazuar në pikat 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

**Kryesuese e trupit gjykues**

**Xhensila PINE/kundër**